

## Poeti dhe politikat Danilo Kish përtej "jogës dhe komisarit"

Aleš Debeljak\*

Ballkani nuk është vetëm një gadishull malor në Evropën Juglindore, të cilit i mungojnë kufijtë natyror me Evropën Perëndimore dhe i cili ka një emër që i vuri gjeografi gjerman, August Zeune, në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, duke ndjekur gjurmët e një hartografi të mëparshëm turk. Në dy shekujt e fundit të luftës dhe zhvendosjes së dhunshme të kufijve nën presionin e Perandorive të Habsburgut dhe Otomane, me mbështetjen e Fuqive të Mëdha Perëndimore dhe Ruisë, Ballkani u bë edhe një metaforë e përshtatshme. Ai u bë metaforë kryesisht për një *forma mentis* (formë më vete), për një njeri të ashpër dhe mentalitet të dikurshëm, që nuk i nënshtrohet arsyeve moderne, një mentalitet, metastazat e të cilit mund të prekin qytetërimin "e shëndetshëm" në botën e kapitalizmit global.

Ballkanizimi i një komuniteti të caktuar sot është kryesisht një fjalë e shpifur, e cila ka shndërruar fragmentimin narcisoid të kolektiveve të gjera në disa grupe të vogla që e fusin veten e tyre në gjakderdhje dhe urrejtje mizore, në moralizim dinak të pastërtisë, si dhe në përjetim ritual të të drejtave të lashta. Shprehitë e jetës dhe mendja "evropiane" nuk janë menjëherë në dispozicion këtu, në Ballkan.

Sidoqoftë, ku është, kur themi: »këtu, në Ballkan«? A fillon ai në anën jugore të tarracës së Hotelit Esplanade në Zagreb (?), siç vërejtë me zë të plotë Miroslav Krleža, shkrimtari i njohur modern kroat.

A është e vërtetë që pragu i tij gjendet në tavernat e errëta të *gastarbeiterëve* rreth stacionit jugor të trenit në Vjenë që, ditë pas dite, përgojohen si *petite-bourgeoisie* nga tabloidet austriake? A fillon Ballkani në pjesën jugore të lumit Kolpa, që e ndan

---

\* Dr. Alesh Debeljak, prof. drejtor i Qendrës së Studimeve Kulturologjike dhe Fetare, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Universiteti i Lubjanës.

Sllloveninë nga Kroacia, siç e ka zakon të mendojë një pjesë e madhe e opinionit sllloven?

Vendosja e shenjës e ndan shoqërinë e qëndrueshme nga pasionet fisnore, mirëpo kjo gjë është një pikëpamje e imagjinuar. Ajo mund të transferohet duke iu përshtatur kërkesave të ndryshme të komuniteteve, për të arsyetuar identitetin e tyre përkatës, edhe pse pasojat e këtyre ndërrimeve i përkasin të dy anëve të ndara. Imazhi bashkëkohor i Ballkanit ka dalë pikërisht si rezultat i mutacioneve konceptuale të shumanshme, nga tregimet perëndimore të të tjerëve, të ndryshme dhe shpesh të kaluara dorë pas dore me qëllime native, etnologjike origjinale, dhe një potencë superiore kundër kulturës perëndimore në Ballkan.

Megjithatë, ekziston një traditë kulturore që lejon qarkullimin intensiv të ideve, qëndrimeve e simboleve përtej të gjithë kufijve etnikë dhe gjuhësorë, një traditë kozmopolite. Kjo traditë mund të ketë qenë e hollë mes dy luftërave botërore, por ajo përfshiu lëvizjen historike avangarde me kthimin e vërtetë të Ballkanit në *Zenitizëm*, siç e ka thënë Ljubomir Miçiç para pesë vjetëve. Revista e tij *Zenit*, e cila lexohet në formë të një katalogu ekspresionizmi gjerman dhe strukture ruse, ndërsa ideja e tij origjinale "Barbarogenius", një njeri autentik nga Ballkani i cili në zenitin e tij krijues dëshiron të injektojë gjak të freskët në Evropën e kalbur, tërhoqi në mënyrë të përkryer besimin popullor se popujt e Ballkanit janë të panjolllosur me intelektin e korruptuar evropian. Kishte ndodhur një dridhje e kadencës në zërin e poetit sllloven, Srećko Kosovel, i cili u ndikua nga Zenitizmi; ka pasur ndërhyrje elegante mbi kalimin e kohës në poezitë e një poeti kroat, Tin Ujević; dhe pranimi fatalist i mjerimit në veprën e Ivo Andrić në të cilën serbët, kroatët dhe boshnjakët paraqiten si të njëjtë. Mirëpo, asnjëri prej këtyre shkrimtarëve nuk vazhdon të ma tërheqë imagjinatën time të etshme në këtë mënyrë të fuqishme si puna e Danilo Kishit.

Danilo Kish (1935-1989), një shkrimtar i letërsisë artistike, përkthyes i shumanshëm dhe një *bonvivant karizmatik*, ishte një liberal i realizimit socialist dhe i estetikës zyrtare të artit jugosllav pas Luftës së Dytë Botërore. Sfondi i tij kulturor u animua nga tradita çifute, serbe, hungareze, siç shkroi ai në

udhëkryqet e trashëgimisë austro-hungareze dhe të Ballkanit. Fëmija i Jorge Luis Borges-it dhe Bruno Schulz-it, u zhvillua jashtë gjuhës së tij amtare, e cila deri më 1991 u njoh si "serbo-kroatisht". Me gjithë faktin që prindërit e tij ishin letrarë, ai gjeti lirinë për ta zhvilluar imagjinatën e tij edhe më mirë.

Megjithatë, Danilo Kish nuk ishte në asnjë mënyrë i lirë nga besnikëria morale; i ndruajtur, ai përqafoi titullin e "shkrimtarit të fundit jugosllav", i cili përfshiu rezistencën e tij të vazhdueshme kundër ideologjisë nacionaliste. Sidoqoftë, unë u udhëzova nga njohja e tij, gjithashtu e rëndësishme, se ai është pikërisht një shkrimtar që bëri thirrje për të mbështetur një domosdoshmëri ekzistenciale që mund dhe duhet të refuzojë iluzionin tërheqës të internacionalizmit "lundruës".

Një shkrimtar i cili jeton në një vend ku flitet gjuha e tij amtare, është i vetëdijshëm se gjuha nuk është vetëm një instrument i komunikimit. Ajo është përkundrazi një pikëpamje metafizike e botës. Në qoftë se internacionalizmi "lundruës" supozon që një person mund të jetë plotësisht vendas në një klasë sociale tranzicionale, e cila kërkon mospranimin e lidhjeve të menjëhershme etnike dhe kulturore në emër të besnikërisë komuniste, unë desha të besoj se është e mundur që të qëndroj besnik ndaj mbretërive të lashta të gjeografisë intime, historisë, dhe të komunitetit, paçka dikush nxit një lidhje të lëvizjeve globale kulturore. Duke mënjanuar vrazhdësinë nacionaliste, egoiste dhe ndjenjën e pakuptimtë të "shtetësisë globale," unë kam tentuar të ndjek qarqet bashkëqendrore të identitetit, që burojnë nga imazhet e krijuara vetë nga përvoja komunale nëpërmjet rrymave të identiteteve lokale, kombëtare dhe rajonale.

Ky identitet është shpallur vetëm për atë që ka një vështrim të ngulët dhe forcë transformuese për të gërryer përshkrimet lokale të ngulitura të jetës së përditshme, duke i kthyer ato në një histori me kuptime gjithësore (universale). Ky është vështrim i ngulët i mjeshtërive, artistëve dhe shkrimtarëve, në punën e të cilëve reflektimi i pjekur udhëton në të njëjtin kompartiment, ashtu si rrëfimi për një komunitet të zgjedhur që ndryshon nga grupi etnik ose gjuhësor i personit përkatës.

Një perspektivë e tillë kozmopolite kërkon, në të vërtetë, një zgjedhje individuale, meqë ajo kalon një anëtarësim organik.

Ajo kërkon një zgjedhje të një anëtarësimi në një komunitet bishtnues, në të cilin imperativi për të qenë njeri nuk është vetëm një e drejtë e dhënë, por edhe një përgjegjësi.

Ajo që mund të na mbrojë të gjithë neve, të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në llojin e jetës, në të cilën ideja e një njerëzimi të përbashkët ende nuk ka humbur krejtësisht, është ndoshta vetëm një shpresë e brishtë se qëndrimi kritik ndaj ideologjive në modë ofron, në të njëjtën kohë, një rezistencë të gjendjes ekzistuese dhe na ndalon pranimin fatalist e një fatkeqësie si një aspekt të patjetërsueshëm të përvojës.

Danilo Kish ishte për mua një shkrimtar hero. Me insistimin e tij moral që pyetja qendrore për shkrimtarët e shekullit njëzetë, ishte çështja e kampeve Aushvic dhe Gulag; me procedurat e tij lirike që strehuan, që të dyja, fantazmat mbi litaninë e stacioneve hekurudhore provinciale dhe një dridhje të shpirtit të shqetësuar; me pretendimin e tij se kici është i pathyeshëm si një shishe plastike; me dorëheqjen e tij ende nuk u kuptua fakti se për atë, që ka jetuar dekadën e fundit të jetës vullnetarisht në një mërgim parisien, debatet intelektuale franceze të kohës ishin të njohura, ndërsa debatet amtare të tij ishin të huaja për kolegët e tij francezë; me bindjen e tij të vazhdueshme se në një literaturë është shkruar me tërësinë e një personi, jo vetëm me gjuhën e përdorur, gjë që e bëri atë të kapet pas idiomës letrare serbo-kroate përkundër konfrontimeve të pavërteta në frëngjishte, gjuhë e mërgimit në jetën e përditshme; me qëndrimin e tij parimor të një "çifuti endacak", i cili nuk mund të jetë i harruar për pasojat shkatërruese të lartësisë shoviniste "popullit të zgjedhur në nivelin e idesë metafizike i cili, nga ana tjetër, i arsyeton të gjitha mjetet e avancuara për mbrojtjen e tij; me narrativin gjithëpërfshirës të jetës dhe të punës së tij, Danilo Kish për mua ka përfaqësuar realizimin më fisnik të imagjinatës mbi Ballkanin.

Unë, Danilo Kishin e kam zbuluar në fillim të viteve 1980 kur, si një student në Universitetin e Lubjanës, Slloveni, ndaja me të një shtëpi të madhe të Jugosllavisë.

Kontakti im me tregimet e tij ishte një lloj zbulimi, meqë puna e tij atëherë nuk ishte akoma e njohur. Në fakt, me rastin e publikimit të një përmbledhjeje të tij me tregime të shkurta, *The Tomb for Boris Davidovich* (publikimi i parë më 1976; dy vjet më

vonë publikoi Harcourt Brace Jovanovich, këtë edhe me përkthimin në anglishte), shpërtheu një polemik e potershme mbi përdorimin e duhur të metodave letrare.

Kish u bë objekt i vrasjeve politike dhe ngacmimeve nga regjimi komunist që përfundoi me emigrimin e tij. Danilo Kish mërgoi në Paris. Unë mërgova në librat e tij. Dy dekada më vonë, unë jam akoma banor i lumtur i tyre.

Unë vazhdoj të tërhiqem nga Kish, asnjëherë më shumë sesa para fundit të botës, në të cilën temat evropiane mbi ndarjet kombëtare dhe ndarjes së tyre midis "ne" dhe "ata", kanë marrë personifikim të frikshëm global në okupacionin britanik-amerikan të Irakut. Natyrisht, të soditësh frymën e bibliotekës si një depo e një ndjenjeje të komunitetit, është të kënaqesh në vegimin letrar. Megjithatë, të tilla janë ngushëllimet e imagjinatës që unë nuk mund të mos ëndërroj mbi mjeshttrin tim.

Në punën e tij, sidomos në një tregim *Encyclopedia of the Dead* (i publikuar për herë të parë më 1983, të cilin Farrar, Shtraus dhe Giroux e botuan edhe në anglisht më 1989), Danilo Kish shfrytëzoi metaforën e një lloji të veçantë të bibliotekës. Ku ka një bibliotekë letrare, aty është biblioteka e Jorge Luis Borges.

Ishte strategjia e imagjinuar e Borges-it që e bëri Kishin të thoshte që e gjithë letërsia është e ndarë në "një përpara Borges-it dhe një pas tij".

Ky pohim është diskutueshëm, por fakti mbetet se Borges ndikoi fuqimisht në literaturën e Kishit për përdorimin e dokumenteve, kronikave, dhe referencave të bazuara në fakte. Duke lëruar nëpërmjet të vërtetave të tyre përkatëse, Kish krijoi vepra të imagjinuara me një renditje shumë estetike. Borges hartoi një metaforë të një biblioteke, me qëllimin që të jetë një univers. Në tregimin e tij *The Library of Babel* (1941), biblioteka është e madhe sepse përmban një pafundësi të të gjitha ngjarjeve të së kaluarës, të së tashmes dhe të së ardhmes. Biblioteka e Borges-it është aq e pakufizuar sa është edhe shqetësimi i popullit që kërkon më kot një shpjegim të kaosit në raftet e librave të rregulluara.

Kish ishte i impresionuar, por jo i kënaqur. Ai zgjodhi një interpretim të mprehtë, pasionant dhe pa dyshim një polemikë të plotë mbi përdorimin e figurave në *Encyclopedia of the Dead*.

Së pari, enciklopedia e Kishit, libër esencial i bibliotekës, është e hapur vetëm për ata njerëz që janë tashmë të vdekur. Së dyti, mekanizmi përzgjedhës është në punë, madje edhe brenda një komuniteti të të vdekurve, meqë biblioteka e Kishit përjashtonte ata emra, të cilët tashmë kanë merituar një përfshirje në ndonjë libër tjetër, leksikon, apo bibliotekë.

Njerëzit, të cilët nuk kanë arritur të hyjnë në asnjë nga vjetarët e njerëzve të shquar (*Who's Who*), kanë gjetur kështu njohjen e tyre të vetme në enciklopedinë e vërtetë të të vdekurve, të të paemërve, të kalimtarëve të rastit dhe të fqinjëve. Ky gjest metodologjik nuk është asgjë tjetër pos një festë e barazisë së vdekjes. Ai është një lloj kujtese e zyrtë për parimin e injoruar të lirisë, vëllazërisë dhe barazisë.

Unë nuk jam duke thënë se në kohën e trazirave të vazhdueshme sociale Kishi luan vetëm një rol të bamirësit, puna e të cilit është të lehtësojë një dhimbje. Në fund të fundit, dhimbja na detyron të mendojmë, të menduarit mund të zhvillohet në mençuri dhe mençuria e bën jetën disi të durueshme. Unë po them që përmbysja radikale e fantazisë dhe barazisë është kontributi origjinal i Kishit për të kuptuar kushtet moderne të njeriut: barazia e të vdekurit, vazhdon të jetë e shënuar me marrëdhënie konkrete shoqërore që ka shënuar përvoja e jetuar e njerëzve. Me fjalë të tjera, bindjet përçarëse politike dhe ndarjet e statuseve sociale të individëve, i ndjekin ata përtej varrit. Logjika e hyrjeve në enciklopedi lidhet me një farë lloj hermeneutiku qërues. Rrjeti i ngjarjeve, ninullat e kënduara nga të vdekurit, të afërmit dhe mysafirët e dasmës, postierët me këmbë të lehta si pendël dhe ato të mjelësit të lerosur, rrjet ky i të gjithë njerëzve që të vdekurit dëshironin t'i shihnin, njihnin apo nuhasnin, është i pafund. Por, a nuk është thënë kjo në mënyrë të çalë? Rrjeti në të cilin një individ është kapur është, në fund të fundit, aq i gjerë sa që vërtet e përfshin të gjithë botën, çdo personi, herët ose vonë, i kryqëzohen shtigjet me personin që ka qenë në kontakt me të njohurit e të vdekurit.

Meqë degëzimet e rrjetit përfshijnë të afërmit dhe të afërmit e të afërmeve, si dhe të njohuritë dhe takimet rastësore, supozimi i enciklopedisë së të vdekurit është, në fund të fundit, i çliruar: ajo aludon që ne jemi të lidhur me të gjitha gjërat e gjalla dhe të

vdekura dhe njerëzit në botë. Labirinti, çpleksja e pamundur e lidhjeve, horizontalisht dhe vertikalisht, ky labirint është kaq i gjerë, sa që gjatë leximit tim të parë të tregimeve të Kishit, kisha një ndjenjë emocionuese, jashtëzakonisht të ngjashme me hartën e saktë të Anglisë, e cila është në fakt vetë Anglia, siç tregoi Josiah Royce në librin e tij *The World and the Individual* (1899). Harta e tij përshëndeti një përsëritje *ad infinitum*, çdo hartë e Anglisë duhet të përmbajë vetveten dhe, në këtë mënyrë, të grumbullojë hap pas hapi një mori të imazhit të vet.

Enciklopedia e Kishit është, megjithatë, tashmë një mori ekzistuese. Në interpretimin e shkëlqyer të Kishit, fjalori hyrës është metamorfozë dhe linear për nga cilësia e shënimeve, i cili përcakton ligjet e të folurit tonë të përditshëm dhe të jetës kronologjike në një prani të njëkohshme të shumë pjesëve të vuajtura të jetës nga të vdekurit. Me fjalë të tjera, e gjithë historia e një individi është e kondensuar, e përmbledhur dhe e përshkruar; nuk përshkruhet vetëm në një perspektivë të lodhshme të informacioneve lidhur me lindjen, arsimimin, statusin martesor, adresat e ndërruara dhe punët e kryera, por me një ndjeshmëri artistike që bën thirrje për ambicie të idealeve, tërësinë e të qenit.

Një projekt i fshehtë i Stéphane Mallarmé *the Book*, shndrit nëpërmjet kësaj dëshire të papërbushur për të kënduar tërësinë e të qenit, për të jetuar tërësinë e këngës. Mallarmé, themeluesi i simbolizmit francez në fund të shekullit 19, adhuroi gjuhën dhe potencialin e saj për një sintezë si në ëndërr, në të cilën të gjitha vetë-ndarjet janë kapërcyer dhe "të gjitha qeniet tokësore duhet të jenë përfundimisht të përmbajtura në libër". S'ka dyshim që Mallarmé, kurrë nuk e shkroi librin. Parimi i tij që të gjithë dhe çdo gjë që ndodh në botë duhet të mbërrijë një ditë në Libër, megjithatë, nuk mori vetëm rigjenerim estetik të bukur, por edhe të ndjeshëm shoqëror nën stilolapsin e fërgëlluar të Danilo Kishit, mjeshtri im i Ballkanit. Në gjurmët e tregimit të tij morra guximin të shkruaj këtë haraç, një parafrazë, një formë mirënjohjeje:

*Tregimi i Mjeshtrit dhe Nxënësit*

nga agimet e Pragës dhe errësira kaltëroshe,  
 i rëndë si një pëllumb i vdekur në plogështinë e së shtunës,  
 i venitur nga një libër që unë nuk guxoj ta hap,  
 e di atë përmendsh, imiton gjithësinë,  
 nga një simetri prej dyzet vjetësh dhe gjashtë librash  
 që ishin të shkruara nga shumë vetë në dëshpërim,  
 nga dashuria, nga pluhuri brenda një godine, nga poemat e lexuara  
 me një frymë të vetme, nga dy ose tre neologjizma,  
 nga durimi dhe disiplina, të cilët kalojnë në mushkëritë e mia,  
 nga papërkrahja dhe nga përsëritja e thartë,  
 nga besimi në tridhjetë e gjashtë burrat e mençur,  
 nga mësimi i parë Tallmud,  
 nga vizionet e mjegullta dhe aluzionet e dështuara,  
 nga vetmia e përjetshme dhe krenaria e barabartë,  
 nga guximi dhe një këngë zbavitëse e padobishme,  
 nga kujtimet e pakëndshme të mitit *Pygmalion*  
 sot më shumë se kurrë të gjalla, nga një tregim  
 futur në tregimin e dikujt tjetër dhe ndoshta edhe më pak të  
 suksesshëm se origjinali, i cili është në vetvete, por  
 një kronikë e keqe e një legjende që erdhi për të kaluar  
 shumë herë, nga arroganca e mjeshtrit  
 për t'i rraskapitur metaforat dhe besimin e studentëve,  
 nga gungat dhe absurditetet, nga loja libri i lexuar  
 po luan me mua, nga insistimi i mjeshtrit  
 se ai duhet të ndjejë dhimbjen djegëse të mendjemadhësisë në qoftë se  
 ai do që të japë një mësim mbi rrezikun e saj,  
 nga reflektimet dhe nga hijet në dhomë pa pasqyrë,  
 nga urtësia dhe zërat e ulët nga e kaluara unë nuk mund të  
 shkruaj një tregim i cili do të përftojë në mendje me vite të tera që nga tash  
 nga një njeri që i përkushtohet leximit dhe shkrimit  
 si unë vetë.  
 Nuk e di nëse ky njeri do të jetë përsëri unë.

*Përktheu nga anglishtja Dafina Vezaj*